

20101402846

L I G J
PËR NGARKIMIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË TE BANKA PËR ZHVILLIM
PRANË KËSHILLIT TË EVROPËS SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR
FINANCIMIN E PJESSHËM TË PROJEKTIT PËR REKONSTRUKSIONIN E
INSTITUCIONEVE NDËSHKUESE-PËRMIRËSUESE

Neni 1

Republika e Maqedonisë ngarkohet te Banka për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës me hua prej 46 000 000 eurosh, për financimin e pjesshëm të Projektit për rekonstrukcionin e institucioneve ndëshkuese-përmirësuese.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të mjeteve të huas nga neni 1 të këtij ligji, do të përcaktohen me Marrëveshjen kornizë për hua për financimin e pjesshëm të Projektit për rekonstrukcionin e institucioneve ndëshkuese-përmirësuese, e cila do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bankës për Zhvillim pranë Këshillit të Evropës.

Kushtet e shfrytëzimit të mjeteve të çdo transhe në veçanti do të përcaktohen me Marrëveshjet plotësuese për hua, të cilat janë pjesë plotësuese e Marrëveshjes kornizë për hua për financimin e pjesshëm të Projektit për rekonstrukcionin e institucioneve ndëshkuese-përmirësuese.

Në emër të Republikës së Maqedonisë, Marrëveshjen kornizë për huan nga paragrafi 1 të këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i pagesës së huas nga neni 1 të këtij ligji është më së shumti 20 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej 5 vitesh.

Transha e parë duhet të tërhiqet në afat prej 12 muajsh nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji dhe nuk duhet të tejkalojë 25% nga shuma e përgjithshme e huas.

Tërheqja e çdo transhe vijuese do të realizohet pasi që Republika e Maqedonisë me shkrim do ta njoftojë Bankën për Zhvillim pranë Këshilli të Evropës, se 90% e shumës të transhës paraprake është alokuar.

Neni 4

Shkalla e interesit do të përcaktohet për çdo transhë të huas veç e veç në ditën e tërheqjes së mjeteve të huas, varësisht nga ajo se cila shkallë e interesit është më e përshtatshme për Republikën e Maqedonisë (fikse apo variable).

Neni 5

Projektin për rekonstrukcionin e institucioneve ndëshkuese-përmirësuese nga Marrëveshja kornizë për hua nga neni 2 paragrafi 1 të këtij ligji, do ta realizojë Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e për Zbatimin e Sanksioneve.

Neni 6

Republika e Maqedonisë huan do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".